

VENDIM
Nr. 118, datë 13.2.2020

**PËR PËRCAKTIMIN E PROCEDURËS SË VLERËSIMIT TË KONTRIBUTIT
TË DONACIONEVE NË FORMËN E PASURIVE TË PALUAJTSHME**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të shkronjës “p”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Financave dhe Ekonomisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në zbatim të shkronjës “p”, të pikës 1, të nenit 21, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, të ndryshuar, vlera e pasurive të paluajtshme të dhuruara për rastet e shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, sipas parashikimeve në ligjin nr. 97/2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, njihet si shpenzim i njohur, sipas përcaktimeve të këtij vendimi.

2. Në zbatimin e këtij vendimi, termi “fatkeqësi natyrore” ka të njëjtin kuptim sipas përcaktimit në ligjin nr. 97/2019, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore”.

3. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara nga tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, vlera e pasurive të paluajtshme, për efekt të llogaritjes së masës së nivelit të shpenzimeve të njohur, konsiderohet vlera kontabël neto, e pasqyruar në bilancin e shoqërisë përpara momentit të dhurimit, minus shumën e amortizuar deri në periudhën e dhurimit.

4. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara nga tatimpaguesit që janë subjekt i tatimit mbi fitimin apo i tatimit të thjeshtuar mbi fitimin, të rivlerësuara më parë, vlera e pasurive të paluajtshme, për efekt të llogaritjes së masës së nivelit të shpenzimeve të njohur, konsiderohet vlera e rivlerësuar, për të cilën është paguar tatimi, sipas akteve ligjore në fuqi në momentin e rivlerësimit të pasurisë së paluajtshme.

5. Për pasuritë e paluajtshme të dhuruara, tatimpaguesit duhet të disponojnë dokumentacionin e fitimit të pronësisë.

6. Në rastet kur pasuria e paluajtshme, e regjistruar në bilancin e shoqërisë, është e ndërtuar nga vetë shoqëria apo nga një nënkontraktor, si shoqëri ndërtuese, si vlerë e pasurisë do të konsiderohet vlera e investimit e dorëzuar në organet e pushtetit vendor për efekt të llogaritjes së taksës së ndikimit në infrastrukturë.

7. Vlera e pasurive të paluajtshme të dhuruara nga institucionet financiare bankare dhe jobankare, për efekt të përlllogaritjes së shpenzimit të njohur para tatimit, konsiderohet vlera e pasqyruar në aktivet e bilancit të këtyre institucioneve në momentin e fitimit të aktit të pronësisë, sipas legjislacionit të fushës.

Ky vendim hyj në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama